



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 15 Dhjetor 2020

Nr: 30

VENDIM

**PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË
KANDIDATIT Z. RUDI VIRON PASHAJ NGA LISTA SHUMEMËRORE E PARTISË
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË, PËR KËSHILLIN E BASHKISË VLORË, NË ZBATIM
TË LIGJIT NR. 138/2015 “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË
ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronja “n” dhe paragrafi 2 i Ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 11 i ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; Kreu V i Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur;

VËREN

Me shkresën nr. 8072 prot., datë 22.09.2020, Këshilli i Bashkisë Vlorë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga Këshilltari, z. Shkëlqim Bejkush Leskaj, propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste e Shqipërisë.

Referuar nenit 164, paragrafi 2, i Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 1553/1 prot., datë 14.10.2020, i është drejtuar z. Rudi Viron Pashaj, me kërkesë për plotësim dokumentacioni, si kandidat vijues i listës shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, për Këshillin e Bashkisë Vlorë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit. Ky kandidat nuk ka depozituar formularin e vetëdeklarimit brenda afatit të përllorëgjatur prej 13 ditësh nga data e dërgimit të njoftimit me postë.

Për plotësimin e vakancës në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, Bashkia Vlorë, rezulton se lista e kandidatëve të Partisë Socialiste të Shqipërisë, për Këshillin e Bashkisë



Data: 15 Dhjetor 2020
Nr. 30

Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit z. Rudi Viron Pashaj nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për këshillin e bashkisë Vlorë

Vlorë, ka shteruar. Sipas nenit 164, paragrafi 4, të Kodit Zgjedhor, në rast se lista e kandidatëve të partisë politike, anëtare e një koalicioni ka shteruar, mandati i kalon partisë së koalicionit me herësin më të lartë.

Referuar vendimit të Kolegjit Zgjedhor nr. 41, datë 25.07.2019 “Për shpërndarjen e mandateve për Këshillin e Bashkisë Vlorë për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore 2019, si dhe në bazë të nenit 164, paragrafi 4 i Kodit Zgjedhor, herësi më i lartë brenda koalicionit i takon subjektit politik Partia Demokracia Sociale.

Në këto kushte për zëvendësimin e vakancës sipas përcaktimeve të nenit 164, paragrafi 2 i Kodit Zgjedhor me kandidatin e radhës të listës shumemërore të Partisë Demokracia Sociale, për Këshillin e Bashkisë Vlorë, të cilit i kalon mandati i Këshilltarit, me shkresën nr.1672 prot, datë 06.11.2020, i është drejtuar zj. Leonora Kiço Hyso.

Kandidati për këshilltar përcaktuar në bazë të listës shumemërore të subjektit politik Partia Demokracia Sociale, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit me numër 0049 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për anëtar zj. Leonora Kiço Hyso, në këshillin e bashkisë Vlorë, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Në datën 23.11.2020 ka mbërritur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ankesa e bashkëshoqëruar me formularin e vetëdeklarimit e z. Rudi Viron Pashaj, e protokolluar me nr.2042, datë 17.11.2020, i cili sqaron se e ka dërguar formularin e vetëdeklarimit brenda afatit ligjor të përcaktuar nga ligji, por për shkak të mbylljes së postës herë pas herë nga situata e pandemisë, është vonuar dorëzimi i shkresës së tij. Bashkë me ankesën dhe formularin, z. Rudi Viron Pashaj ka sjellë edhe mandatin e postës për të vërtetuar pretendimet e tij. Ky mandat mban datën e dërgimit 20.10.2020 dhe nr.barkodi EN881018743AA.

Nëpërmjet mandatit të postës, z. Rudi Viron Pashaj vërteton se ai e ka nisur formularin brenda afatit ligjor por për shkaqe që nuk varen nga ai, formulari nuk ka ardhur brenda afatit ligjor në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.



Në këto kushte, bazuar në nenin 57 dhe 155 të Kodit të Procedurave Administrative, kur vërtëtohet dita e depozitimit të kërkesës në postë, kur kërkesa dërgohet me postë të porositur, për efekt të llogaritjes së afateve procedurale që ecin në dëm të palës dhe është brenda afatit ligjor, atëherë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ndërpret procedurën e verifikimit për zj. Leonora Kiço Hyso, për të vazhduar procedurat me kandidatin të cilit i është dërguar kërkesa më parë, pra me z. Rudi Viron Pashaj.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, paragrafi 2, shkronja "b" dhe paragrafi 3, shkronja "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", me shkresën nr. 2100 prot., datë 24.11.2020 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 2099 prot., datë 24.11.2020 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar z. Rudi Viron Pashaj, në Këshillin e Bashkisë Vlorë, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës tonë për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar në këshillin e bashkisë Vlorë, z. Rudi Viron Pashaj.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore me shkresën nr. 12019/1 prot., datë 27.11.2020 ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar z. Rudi Viron Pashaj, në këshillin e bashkisë Vlorë, i cili rezulton me status i padënuar nga gjykatat shqiptare.

Referuar nenit 49 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" këshilli i bashkisë ka kompetencën për dhënien e mandatit, anëtarit të këshillit bashkiak.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar paragrafi 2, Kreu V të vendimit nr.17/2016 të Kuvendit konstaton se, për kandidatin për anëtar z. Rudi Viron Pashaj, në këshillin e bashkisë Vlorë, të dhënat e të cilit nuk përbëjnë kusht për mos zgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit, duhet të vazhdojnë procedurat për dhënie mandati nga këshilli i bashkisë Vlorë.



PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronja “n” dhe paragrafi 2 i Ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; nenin 11 i ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; Kreu V i Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

VENDOSA:

1. Z. Rudi Viron Pashaj, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë Vlorë, i subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Vazhdimin e procedurave nga këshilli i bashkisë Vlorë, për dhënien e mandatit, kandidatit të listës shumëmemërore z. Rudi Viron Pashaj, i subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë, për plotësimin e vendit vakant në Këshillin e Bashkisë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative së Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

